REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr.76, datë 20/12/2005

"MBI MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE DHE SHPENZIMEVE PËR NJËSINË E ZBATIMIT TË PROJEKTIT "PËR NDËRTIMIN DHE REHABILITIMIN E SHKOLLAVE TË TIRANËS"

Në mbështetje të ligjit Nr.8652, dt.31/07/2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", neni 16, pika 5, neni 19, pika 7/c/III, neni 73, pika 4, të ligjit Nr.7776, dt.22/12/1993 "Për buxhetin lokal", ndryshuar me ligjin Nr.8399, dt.09/09/1998, Marrëveshies së Kredisë F/P1509 të lidhur më dt.09/05/2005 midis Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Bankës për Zhvillim të Këshillit të Europës (CEB), Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.308, dt.28/04/2005 "Për miratimin në parim të marrëveshjes së kredisë, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës për Zhvillim të Këshillit të Europës (CEB), për financimin e fazës së parë të projektit të ndërtimit dhe rehabilitimit të shkollave të Tiranës", ligjit Nr.9406, dt.19/05/2005 "Për ratifikimin e marrëveshjes së kredisë ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës për Zhvillim të Këshillit të Europës (CEB), për financimin e fazës së parë të projektit të ndërtimit dhe rehabilitimit të shkollave të Tiranës", Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.32, dt.20/07/2005 "Për realizimin e projektit të rehabilitimit të 12 shkollave dhe ndërtimin e 7 shkollave të reja në qytetin e Tiranës", Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.297, dt.27/06/2002 "Për disa shtesa e ndryshime në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.26, dt.21/12/2000 "Për rritjen e pagave të punonjësve të institucioneve buxhetore" i ndryshuar, pika 9, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I;

1. Të miratojë nivelin e pagave të Njësisë së Zbatimit të Projektit për "Ndërtimin dhe rehabilitimin e shkollave të Tiranës" (faza e parë), sipas tabelës Nr.2 pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

2. Të miratojë detajimin e shpenzimeve për paga e sigurime, shpenzime operative e investime, sipas tabelës Nr.1 pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

3. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Njësia e Zbatimit të Projektit.

4. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

LUAN SHAHOLLARI